

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Qendër Lindje Korçë (Rishpallje 3 lote)”

---

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punime për mirëmbajtjen e rrugëve 45233141-9

---

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**Fondi limit i përgjithshëm i Marveshjes Kuadër: 540,165,494.45** (pesëqind e dyzet milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër pikë dyzet e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Në Euro: **5,468,369.05** (pesë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë zero pesë) **Euro pa TVSH.**

- **Loti 3:** Mirëmbajtje me performancë: Korçe - Erseke (Rruga e re) (34.2), dhe Deg. Q. e Qarit - Erseke (Rruga e vjeter) (25.1), L = 55.9 km, me vlerë totale **192,904,028.39** (njëqind e nëntëdhjetë e dy milion e nëntëqind e katër mijë e njëzet e tetë pikë tridhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH.** / Në Euro: **1,952,865.23** (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë njëzet e tre)

- **Loti 4:** Mirëmbajtje me performancë: Unazë - Ersekë (2.1) + Ersekë - Leskovik (42.8) + Rr. Leskovik - Tre Urat (Doganë) (13.7), L = 58.7 km me vlerë totale **165,010,597.27** (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e dhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë pike njëzet e shtatë) **Lekë pa TVSH.** / Në Euro: **1,670,485.90** (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë)

- **Loti 5:** Mirëmbajtje me performancë: Libonik - Lozhan - Molla Grabove (kufi Gramsh), L = 53.1 km me vlerë totale **182,250,868.79** (njëqind e tetëdhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH.** / Në Euro: **1,845,017.90** (një milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë).

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Autoriteti Rrugor Shqiptar** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedurat e prokurimit janë të parashikuara Buxhetin e Shtetit për vitin 2024, për Autoritetin Rrugor Shqiptar sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 718/1 prot, datë 24.01.2024 “*Miratimi i detajimit të planit të buxhetit, për shpenzimet korrente për vitet 2024-2026, për shpenzimet operative, llogaria 602 (90605AB)*”. Bazuar në nenin 42 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 pika 1

Në zbatim të pikës 2 të nenit 56 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; dhe pikës 3 të nenit 24 të Vendimit nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti Kontraktor do të publikojë Njoftimin e kontrates në gjuhën Anglese në ***Gazetën Europiane***.

Në zbatim të pikës 2 neni 12 të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021, Autoriteti kontraktor ka konvertuar vlërën limit të kontratës në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të bankës së Shqipërisë (Data 08.10.2024 ora 12:28:08). **1 Euro = 98.78 Lek**

---

**Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:**

#### **2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

**Po**

**X**

**Jo**

**Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:**

- Për të provuar përvojën e mëparshme (**shërbime të ngjashme**):
  - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (**licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës**):
  - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

**Argumentimi ligjor:** Në mbështetje të Nenin 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

**Argumentimi teknik:** Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi **përvojën e mëparshme të operatorit i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit.** Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi.

**Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:** I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë. II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente: - Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri; - Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë; - Kapacitetet financiare. **Duke qenë se pikat e licencës përfitohen si rezultat i eksperiencës dhe cilësisë, ato i përkasin vetë shoqërisë, dhe shfrytëzohen në harmoni me të gjithë komponentët që përbëjnë këtë shoqëri.**

Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kritere.

#### A)<sup>1</sup> **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X**

Sipas rëndësisë:

<sup>1</sup> **Shënim.** Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

- **Çmimi** **pikët [0 - 70]**
- **Cilësia** **pikët [0 - 20]**
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** **pikët [0 - 10]**

## **Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto**

### **Kriteret e vlerësimit:**

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b, 3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

### **1. Çmimi [0 - 70 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

$P_{k1}$	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
$O_{k1}$	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024)*

### **2. Cilësia [0 - 20 pikë]**

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket:

metodave të përdorura, [0 – 2.5 pikë]

personelit kryesor,	[0 – 2.5 pikë]
disponueshmërisë së pajisjeve kryesore,	[0 – 2.5 pikë]
organizimi i stafit,	[0 – 2.5 pikë]
siguria,	[0 – 2.5 pikë]
sigurimit të cilësisë,	[0 – 2.5 pikë]
planit të mobilizimit,	[0 – 2.5 pikë]
garancia e punimeve te rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër.	[0 – 2.5 pikë]

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024). Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin, përvojën e stafit, disponueshmërinë e pajisjeve kryesor, sigurimin e cilësisë etj., ku të gjitha së bashku kanë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.*

### **3. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0 - 10 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. [0 - 7 pikë]
  - i. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efiçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. [0 – 2 pikë]
  - ii. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. [0 – 2 pikë]
  - iii. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0 – 3 pikë]
- b. [0 - 3 pikë]
  - i. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0 - 3 pikë]

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket çështjeve të impaktit në mjedis dhe social që përfshihen në punimet që do të kryhen. Operatori ekonomik duhet të ndjekë parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke përdorur Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si një instrument për mbrojtjen e mjedisit duke identifikuar dhe vlerësuar efektet e mundshme direkte dhe indirekte për parandalimin e tyre.

Operatori ekonomik kryen mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet parandalimit, zbutjes dhe kompensimit të dëmeve të projekt propozimit i cili mund të shkaktojë efekte negative të rëndësishme mbi mjedisin për shkak të madhësisë, natyrës ose zonës ku parashikohet të zbatohet.

---

- Loti 3: Mirëmbajtje me performancë: Korce - Erseke (Rruga e re) (34.2), dhe Deg. Q. e Qarit - Erseke (Rruga e vjeter) (25.1), L = 55.9 km, me vlerë totale 192,904,028.39 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milion e nëntëqind e katër mijë e njëzet e tetë pikë tridhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH. / Në Euro: 1,952,865.23 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjatëdhjetë e pesë pikë njëzet e tre)

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 12;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 3; (Faza e dytë)

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 4; (Faza e dytë)

e. Listën e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 6.

f. Formularin e Kërkesës për pjesëmarrje, sipas Shtojcës 1.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës Nr. 12

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Lloji i procedure është "Sherbim" Mbi kufirin e lartë monetar", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "dyfishin e vlerës së perlllogaritur të kontratës ose Lotit" Eshtë përcaktuar "Jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet " me argumentimin për të pasur me shumë konkurrence " dhe në procedurat e prokurimit "Shërbim" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (garkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit
  - situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë



- situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **30%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar me VKM Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4/C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5/A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-12/A	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-5/A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
6	NS-6/B	Sinjalistika rrugore jondriçuese
7	NS-7/A	Barriera dhe mbrojtja rrugore

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gërmimi në tokë	Punime gërmimi në trupin e rruges, në rrugë dytesore, në vepra arti të vogla, në rjetin e kanalizimit të ujrave të shiut, si dhe në punimet për linjat rezerve	0-20Mln	616,396.00
NP-4-C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Perfshin gjithë punimet në rrugë.	51-100 Mln	64,901,203.66
NP-5-A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti	Punime vepra arti të vogla dhe të mëdha	0-20 Mln	8,105,827.28
NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore	Punime prishje, gërmimi, dhe gjelberimi	0-20 Mln	6,490,120.37
NS-5/A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	Punime sinjalistike ndriçuese	0-20 Mln	672,328.32
NS-6- B	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike	21-50 Mln	33,645,882.10

NS-7- A	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje Guardrail	0-20 Mln	3,948,059.56
---------	-------------------------------	--------------------	----------	--------------

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **35 (tridhjetë e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Shtator 2024**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas

Shtojcës nr. 12. *“Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Shtator 2024**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Shtator 2024**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Duke qenë se objekti është shërbime dhe shërbime në vazhdimësi për një periudhë 48 muajore të marrëveshjes kuadër dhe kontratat do të lidhen sipas nevojave të autoritetit është e vështirë për të mos thënë e pamundur që numri i punëtorëve për këtë objekt të përcaktohet sipas oreve të punës, pasi orët e punës në këto objekte variojnë edhe sipas stinëve dhe në mënyrë të vecantë edhe sipas kushteve të motit (psh sqarojmë këtu në stinën e dimrit në këtë aks rrugor orët e punës për pastrimin e borës mund të jenë shumë të zgjatura, apo në stinën e vjeshtës për shkak të reshjeve të shiut mund të shkaktohen shembje të cilat kërkojnë orë të konsiderueshme pune).

Prandaj në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve është përdorur edhe eksperiencia e mëparshme ndër vite duke kërkuar një 1 punëtor për 3 km (një sugjerim i tillë ka qenë bërë edhe në specifikimet teknike të modelit të vjetër, atyre të përdorura para vitit 2015), duke qenë se edhe nga eksperiencia e të gjitha këtyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshëm një numer i tillë punëtorësh për të realizuar shërbimin e mirëmbajtjes.

Edhe në seminarin e organizuar nga DPRR në Korrik 2010 në lidhje me kontratat e mirëmbajtjes është konkluduar që për të garantuar shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes duhet minimalisht 1 punëtor për 3 km rrugë. Kjo llogaritje është bërë për secilin lot bazuar në km.

Për të garantuar shërbimet me cilësi dhe për të garantuar sigurinë teknike gjatë kryerjes së shërbimeve në rrugë mjetet kryesore duhet të jenë të pajisur me manovratorë.

Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar (për secilin lot) si borëpastruese, fadroma, dhe (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja të cilët kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, eskavatori dhe asfaltoshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se keto mjete nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.

Ndërsa mjete të tjera janë kërkuar, Kamionat, kamioncine, autobetoniere, (për secilin lot) dhe rrjedhimisht kërkohen drejtues automjeti (shoferë).

Pra përvet punëtorëve të thjeshtë, janë kërkuar edhe manovratorë dhe shoferë të cilët duhen për realizimin e shërbimeve të kërkuara në kontrate. Kështu që për secilin lot janë kërkuar puntorë bazuar në km e secilit lot, manovratorë sipas mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.9 si dhe shoferë për drejtimin e automjeteve të kërkuara po në pikën 2.3.9 për secilin lot. (punëtorë + manovratorë + shofera = në total nr punonjësish)

Për llogaritjen e numrit të punonjësve për punimet e rehabilitimit jemi bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës.

**2.3.4** Kandidati ofertues duhet të disponojë **1 (një) inxhinier Ndërtimi / 1 (një) inxhinier Hidroteknik**, i cili do të jetë **Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve**, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtorë të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. *drejtuesin teknik të shërbimeve duhet të jetë në licencën e shoqërisë dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt pasi do të jetë ai drejtuesi i të gjitha shërbimeve dhe punimeve për objektin*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:

**1 (një) inxhinier Topograf,**

**1 (një) inxhinier Mekanik,**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

*Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Topograf dhe inxhinieri Mekanik. Këto inxhinierë janë kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë. Në specifikimet teknike janë përcaktuar punime të mirëmbajtjes dhe punime të sinjalistikës në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm ing. Mekanik.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin mbështetës**, si më poshtë:

**1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik,**

**1 (një) inxhinier Mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë),**

**1 (një) inxhinier Elektrik,**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Gjeolog / Gjeoteknik, ing. Mjedisit si dhe ing. Elektrik. Në punimet e emergjences kemi situata nga më të ndryshmet si rrëshqitje të cilat kërkojnë të pranishëm gjeolog, ku dhe është kërkuar me kategoritë e licencimit sipas specifikimeve teknike. Inxhinieri i Mjedisit është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të gjelbërimit, si dhe punime estetike në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm atë. Në zbatim të vendimeve të KPP-së, Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.*

*Inxhinieri Elektrik është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të spostimit të linjave elektrike.*

**2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë.** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” për te cilet duhet te paraqese kontrate individuale te punes te vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar si borëpastruese, fadroma, dhe (per mjetet e tjera te vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja te cilet kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar), janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se këto mjete nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 *“Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës*

*Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Frezë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	në pronësi ose me qira	Copë 6
11	Kamionçinë deri në 3.5ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Fabrikë Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim	Copë 1
18	Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)	në pronësi ose me qira	Copë 6

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12.** “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, **si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe



kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për impiantin e asfaltit, të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### **1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton**

*Referuar territorit ku kalojnë akset rrugore shembjet e dherave dhe depozitimi i aluvioneve ne trup te rruges jane te shpeshta. Per kete arsye per te realizuar ne nje kohe shume te shpejte largimin e dherave qe mund te bllokojne rrugen dhe per te kryer nje pastrim sa me te shpejte nevojiten mesatarisht 1 kamion per 20 km.*

*Nisur nga natyra e kontratës (specifikimeve teknike) ku kontraktori është i detyruar që të pastroj kanalet, veprat e artit dhe rrëshqitjet e shpateve etj deri në 500 m<sup>3</sup>, duke pasur parasysh gjatesine e rrugeve per sejcilin lot eshte gjykuar që nevojiten kamjone vetshkarkues për përmbushjen e kontratës. Sasia e mjeteve vetshkarkuese eshte ne varesi te km per sejcilin lot. Gjithashtu nevojiten mjete transporti edhe per transportimin e gjithe materialeve te nevojshme per punime dhe sherbime te ndryshme ne objekt si psh: asfaltobeton, inerte, material per mbushje te trupit te rruges, sinjalistike rrugore, etj.*

### **2. Grejder**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te nivelimit kryesisht gjate punimeve te riveshjes se shtresave asfaltike, nivelimi i bankinave, etj.*

### **3. Rul vibrues**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme gjate riveshjeve me asfalt, per ndertimin e shteses se stabilizantit, binderit e asfaltobetonit, si dhe gjate te mbushjes te gropave me asfalt mbeshetur ne specifikimeve teknike.*

#### **4. Prerese asfalti**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet minimalisht kjo makineri prerese asfalti per te bere prerje te asfaltit te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve mbushje gropash sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **5. Freze asfalti**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **6. Betoniere**

*Për realizimin e punimeve ku përfshihen zërat për betonimin e fragmenteve që kanë nevojë, duhet minimalisht nje betoniere per pregatitjen e betoneve*

#### **7. Autobot Uji**

*Per realizimin e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **8. Autobitumatriçe**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere vazhduar sipas radhes teknologjike ndertimin e shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **9. Asfaltoshtruese**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te riveshjes se segmenteve rrugore me shtresa perkatese asfaltike (binder, asfaltobeton).*

#### **10. Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët.**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te prerjes se bimesise se ulet (barit, etj.) anash bankines.*

#### **11. Kamionçinë deri në 3.5ton**

*Nevojitet per transportin e matrialeve te ndryshme, levizjen e fuqise punetore, veglave te punes, per levizjen e stafit menaxherial, etj. Duke patur paraysh që kontraktori duhet të bëjë edhe kontrollin (monitorimin) e aksit, eshte konsideruar e mjaftueshme nje kamioncine per 30 km.*

## **12. Miniekskavator**

## **13. Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)**

## **14. Ekskavator me goma**

*Te gjitha keto mjete **Minieskavator, Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent), Eskavator me goma,** nevojiten per punime te ndryshme ne rastet e pastrimit te siperfaqes se rruges nga depozitimi i dherave dhe inerteve si pasoje e reshqitjeve nga skarpatat e siperme te rruges, ne rastet e depozitimit te aluvioneve qe sjellin lumenjte, perrenjte, kanalet e ndryshme, etj.,*

*Pra me konkretisht fadroma sherben per largimin e shembjeve dhe ngarkimin e tyre ne kamionat veteshkarkues, apo per shtyrjen e grumbujve te debore. Ne rastet e bllokimeve eshte e domosdoshme nje mjet pastrimi fadrome me kapacitet minimalisht 0.4-1m<sup>3</sup>*

*Ndersa ekskavatori, sherben per pastrimin e kanaleve dhe ne rastet e shembjeve bashke me fadromen koordinojne punen per pastrimin dhe evadimin e dherave me kaminat veteshkarkues. Nga eksperienca eshte e domosdoshme qe mjete i germimit ekskavator te jete me kapacitet minimalisht 0.4-1m<sup>3</sup>.*

## **15. Makineri për vijëzim rrugor**

*Makineria e vijezimit te rruges sherben per te ribere vijezimin e rruges ne varesi te konsumimit te vijezimeve ekzistuese, si dhe per vijezim te ri ne zonat ku behen punime riveshje me asfaltobeton apo mbushje gropash, ashtu si parashikohet ne Preventiva dhe ne Specifikimet teknike.*

## **16. Mjet (Batipal) për vendosje parrakësh metalik (guardrails)**

*Nisur nga ajo cfare parashikojne preventivat dhe specifikimet teknike, ky mjet eshte i domosdoshem per realizimin e vendosjes parrakeve mbrojtes anesor metalik (guardrail) se bashku me aksesoret.*

## **17. Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore**

*Nje nga zerat kryesore te Kontrates jane edhe zerat me punimet per ndertimin e shtresave asfalike dhe konkretisht me binder, asfaltobeton. Keto asfalte nevojiten per kryerjen e punimeve te riparimit te shtresave asfaltike me ane te riveshjes me binder, asfaltobeton, apo mbushjes se gropave me asfaltobeton. Sipas Specifikimeve Teknike asfaltet qe do te perdoren duhet te plotesoje te gjitha parametrat teknike dhe duhet te prodhohet ne nje fabrike asfaltobetoni qe te garantoje keto parametra. Nga eksperienca e Kontratave te meparshme fabrika duhet te jete e montuar dhe ne gjendje pune pasi nevojat per asfaltobeton mund te lindin ne cdo kohe. Gjithashtu fabrikat e asfaltobetonit duhet te jene te pajisura me leje mjedisore pasi ato shkaktojne ndotje mjedisore.*

*Kjo eshte e percaktuar edhe ne VKM n.r 628 date 15.07.2015 ose Ish – KTZ “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe ndertimit te rrugeve”.*

## **18. Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)**

Nevojiten për pjesën e kontratës që ka lidhje me mirembajtjen dimerore të akseve rrugore. Këto mjete janë të domosdoshme për kryerjen e mirembajtjes dimerore. Këto mjete shërbejnë për pastrimin e rrugës nga reshjet e deboret dhe për hedhjen e kripes gjatë rënies së deboret dhe gjatë periudhës me ngricë.

Nisur nga specifikat e objektit kur rreshjet e deboret bien në trajtesisht në të gjithë objektin dhe nisur nga eksperiencat e kaluara është parashikuar që një mjet borepastrues nevojitet për mesatarisht 15 km rrugë mirembajtje dimerore.

Për të realizuar një shërbim sipas kushteve teknike për largimin e deboret nga karrexhata me një borepastruese mund të mbulohet një korsë e rrugës. Me shpejtesinë 10-20km në orë me të cilën levizin borepastrueset mund të realizohet pastrimi në një gjatësi prej rreth 30km të njëjës korsë ose rreth 15km të rrugëve nacionale që janë me dy korsë.

Prandaj për vendosjen e numrit të borepastrueseve për secilin lot jemi nisur nga gjatësia e akseve rrugore (në km) dhe nga fakti i sasisë së reshjeve të deboret.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015      Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015      Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

ISO 45001          Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose entë kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të

*njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura nShtatorësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Specifikimet teknike jane hartuar per çdo ze sherbimi /punimi sipas preventivit te sherbimit / punimeve, gjithashtu jemi bazuar ne eksperiencat e projekteve te mirembajtjes se Bankes Boterore gjate viteve 2009-2012, 2017-2022, si dhe ne eksperiencen e kontratave te mirembajtjes se tre Rajoneve gjate viteve te fundit.***

\*\*\*\*\*

**- Loti 4: Mirëmbajtje me performancë: Unazë - Ersekë (2.1) + Ersekë - Leskovik (42.8) + Rr. Leskovik - Tre Urat (Doganë) (13.7), L = 58.7 km me vlerë totale 165,010,597.27 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e dhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë pike njëzet e shtatë) Lekë pa TVSH. / Në Euro: 1,670,485.90 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë)**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 12;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 3; (Faza e dytë)

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 4; (Faza e dytë)

e. Listën e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 6.

f. Formularin e Kërkesës për pjesëmarrje, sipas Shtojcës 1.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Sipas Shtojcës Nr. 12

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Lloji i procedure është "Sherbim" Mbi kufirin e larte monetar", përcaktimi i vleres se kerkuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " dyfishin e vleres se perlllogaritur te kontrates ose Lotit" Eshte përcaktuar "Jo me e vogel se vlera e parashikuar e kontratës qe prokurohet " me argumentimin per te pasur me shume konkurrence " dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej***

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit
- situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë

- situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **30%** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.



**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës bazuar ne formatin e miratuar me VKM Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	Punime gërmimi në tokë
2	NP-4/B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5/A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-12/A	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-5/A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
6	NS-6/B	Sinjalistika rrugore jondriçuese
7	NS-7/A	Barriera dhe mbrojtja rrugore

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në

		kategorinë përkatëse		kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gjurmimi në tokë	Punime gjurmimi në trupin e rruges, në rrugë dytesore, në vepra arti të vogla, në rjetin e kanalizimit të ujërave të shiut, si dhe në punimet për linjat rezerve	0-20Mln	395,634.00
NP-4-B	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Perfshin gjithë punimet në rrugë.	21-50 Mln	42,169,260.57
NP-5-A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti	Punime vepra arti të vogla dhe të mëdha	0-20 Mln	7,219,672.03
NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore	Punime prishje, gjurmimi, dhe gjelberimi	0-20 Mln	4,216,926.06
NS-5/A	Implante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	Punime sinjalistike ndriçuese	0-20 Mln	384,350.94
NS-6- B	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike	21-50 Mln	28,171,239.24
NS-7- A	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje Guardrail	0-20 Mln	2,647,277.56

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **33 (tridhjetë e tre) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Shtator 2024**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas

Shtojcës nr. 12. *“Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Shtator 2024**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Shtator 2024**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Duke qenë se objekti është shërbime dhe shërbime në vazhdimësi për një periudhë 48 mujore të marrëveshjes kuadër dhe kontratat do të lidhen sipas nevojave të autoritetit është e vështirë për të mos thënë e pamundur që numri i punëtorëve për këtë objekt të përcaktohet sipas oreve të punës, pasi orët e punës në këto objekte variojnë edhe sipas stinëve dhe në mënyrë të veçantë edhe sipas kushteve të motit (psh sqarojmë këtu në stinën e dimrit në këtë aks rrugor orët e punës për pastrimin e borës mund të jenë shumë të zgjatura, apo në stinën e vjeshtës për shkak të reshjeve të shiut mund të shkaktohen shembje të cilat kërkojnë orë të konsiderueshme pune).

Prandaj në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve është përdorur edhe eksperiencia e mëparshme ndër vite duke kërkuar një 1 punëtor për 3 km (një sugjerim i tillë ka qenë bërë edhe në specifikimet teknike të modelit të vjetër, atyre të përdorura para vitit 2015), duke qenë se edhe nga eksperiencia e të gjitha këtyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshëm një numër i tillë punëtorësh për të realizuar shërbimin e mirëmbajtjes.

Edhe në seminarin e organizuar nga DPRR në Korrik 2010 në lidhje me kontratat e mirëmbajtjes është konkluduar që për të garantuar shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes duhet minimalisht 1 punëtor për 3 km rrugë. Kjo llogaritje është bërë për secilin lot bazuar në km.

Për të garantuar shërbimet me cilësi dhe për të garantuar sigurinë teknike gjatë kryerjes së shërbimeve në rrugë mjetet kryesore duhet të jenë të pajisur me manovratorë.

Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar (për secilin lot) si borëpastruese, fadroma, dhe (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja të cilët kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se këto mjete nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.

Ndërsa mjete të tjera janë kërkuar, Kamionat, kamioncine, autobetoniere, (për secilin lot) dhe rrjedhimisht kërkohen drejtues automjeti (shoferë).

Pra përveç punëtorëve të thjeshtë, janë kërkuar edhe manovratorë dhe shoferë të cilët duhen për realizimin e shërbimeve të kërkuara në kontrate. Kështu që për secilin lot janë kërkuar punëtorë bazuar në km e secilit lot, manovratorë sipas mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.9 si dhe shoferë për drejtimin e automjeteve të kërkuara po në pikën 2.3.9 për secilin lot. (punëtorë + manovratorë + shoferë = në total nr punonjësish)

Për llogaritjen e numrit të punonjësve për punimet e rehabilitimit kemi bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës.

**2.3.4** Kandidati ofertues duhet të disponoje **1 (një) inxhinier Ndërtimi / 1 (një) inxhinier Hidroteknik**, i cili do të jetë **Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve**, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. *drejtuesin teknik të shërbimeve duhet të jetë në licencën e shoqërisë dhe do të jetë I pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt pasi do jetë ai drejtuesi I të gjitha shërbimeve dhe punimeve për objektin*

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:

**1 (një) inxhinier Topograf,**

**1 (një) inxhinier Mekanik,**

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Topograf dhe inxhinieri Mekanik. Këto inxhinierë janë kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë. Në specifikimet teknike janë përcaktuar punime të mirëmbajtjes dhe punime të sinjalistikës në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm ing. Mekanik.*

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin mbështetës**, si më poshtë:

**1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik,**

**1 (një) inxhinier Mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë),**

**1 (një) inxhinier Elektrik,**

*\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

*Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Gjeolog / Gjeoteknik, ing. Mjedisit si dhe ing. Elektrik. Në punimet e emergjences kemi situata nga më të ndryshmet si rrëshqitje të cilat kërkojnë të pranishëm gjeolog, ku dhe është kërkuar me kategoritë e licencimit sipas specifikimeve teknike. Inxhinieri i Mjedisit është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në*

*punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të gjelbërimit, si dhe punime estetike në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm atë. Në zbatim të vendimeve të KPP-së, Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.*

*Inxhinieri Elektrik është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të spostimit të linjave elektrike.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **8 (tetë) punonjës manovratorë**. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar si borëpastruese, fadroma, dhe (per mjetet e tjera te vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja te cilet kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar), janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se këto mjete nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e

*cituarra më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës*

*Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Frezë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	në pronësi ose me qira	Copë 6
11	Kamionçinë deri në 3.5ton	në pronësi ose me qira	Copë 3

12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Mjet (Batipal) për vendosje parrmakësh metalik (guardrails)	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Fabrikë Asfaltbetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim	Copë 1
18	Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)	në pronësi ose me qira	Copë 4

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12.** “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, **si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;

Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e asfaltit, të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*



**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### **1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton**

*Referuar territorit ku kalojnë akset rrugore shembjet e dherave dhe depozitimi i aluvioneve në trup të rruges janë të shpeshta. Per kete arsye per te realizuar ne nje kohe shume te shpejte largimin e dherave qe mund te bllokojne rrugen dhe per te kryer nje pastrim sa me te shpejte nevojiten mesatarisht 1 kamion per 20 km.*

*Nisur nga natyra e kontratës (specifikimeve teknike) ku kontraktori është i detyruar që të pastroj kanalet, veprat e artit dhe rrëshqitjet e shpateve etj deri në 500 m<sup>3</sup>, duke pasur parasysh gjatesine e rrugeve per sejcilin lot eshte gjykuar që nevojiten kamjone vetshkarkues për përmbushjen e kontratës. Sasia e mjeteve vetshkarkuese eshte ne varesi te km per sejcilin lot. Gjithashtu nevojiten mjete transporti edhe per transportimin e gjithe materialeve te nevojshme per punime dhe sherbime te ndryshme ne objekt si psh: asfaltobeton, inerte, material per mbushje te trupit te rruges, sinjalistike rrugore, etj.*

### **2. Grejder**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te nivelimit kryesisht gjate punimeve te riveshjes se shtresave asfaltike, nivelimi i bankinave, etj.*

### **3. Rul vibrues**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme gjate riveshjeve me asfalt, per ndertimin e shteses se stabilizantit, binderit e asfaltobetonit, si dhe gjate te mbushjes te gropave me asfalt mbeshtetur ne specifikimeve teknike.*

### **4. Prerese asfalti**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet minimalisht kjo makineri prerese asfalti per te bere prerje te asfaltit te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve mbushje gropash sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

### **5. Freze asfalti**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

### **6. Betoniere**

*Për realizimin e punimeve ku përfshihen zërat për betonimin e fragmenteve që kanë nevojë, duhet minimalisht nje betoniere per pregatitjen e betoneve*

## **7. Autobot Uji**

*Per realizimin e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

## **8. Autobitumatriçe**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere vazhduar sipas radhes teknologjike ndertimin e shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

## **9. Asfaltoshtruese**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te riveshjes se segmenteve rrugore me shtresa perkatese asfaltike (binder, asfaltobeton).*

## **10. Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët.**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te prerjes se bimesise se ulet (barit, etj.) anash bankines.*

## **11. Kamionçinë deri në 3.5ton**

*Nevojitet per transportin e matrialeve te ndryshme, levizjen e fuqise punetore, veglave te punes, per levizjen e stafit menaxherial, etj. Duke patur paraysh që kontraktori duhet të bëjë edhe kontrollin (monitorimin) e aksit, eshte konsideruar e mjaftueshme nje kamioncine per 30 km.*

## **12. Miniekskavator**

## **13. Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)**

## **14. Ekskavator me goma**

*Te gjitha keto mjete **Minieskavator, Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent), Eskavator me goma,** nevojiten per punime te ndryshme ne rastet e pastrimit te siperfaqes se rruges nga depozitimi i dherave dhe inerteve si pasoje e reshqitjeve nga skarpatat e siperme te rruges, ne rastet e depozitimit te aluvioneve qe sjellin lumenjte, perrenjte, kanalet e ndryshme, etj.,*

*Pra me konkretisht fadroma sherben per largimin e shembjeve dhe ngarkimin e tyre ne kamionat veteshkarkues, apo per shtyrjen e grumbujve te debores. Ne rastet e bllokimeve eshte e domosdoshme nje mjet pastrimi fadrome me kapacitet minimalisht 0.4-1m3*

*Ndersa eskavatori, sherben per pastrimin e kanaleve dhe ne rastet e shembjeve bashke me fadromen koordinojne punen per pastrimin dhe evadimin e dherave me kaminat veteshkarkues. Nga eksperienca eshte e domosdoshme qe mjeti i germimit ekskavator te jete me kapacitet minimalisht 0.4-1m3.*

### **15. Makineri për vijëzim rrugor**

*Makineria e vijezimit të rrugës shërben për të ribërë vijëzimin e rrugës në varësi të konsumimit të vijezimeve ekzistuese, si dhe për vijëzim të ri në zonat ku behen punime riveshje me asfaltobeton apo mbushje gropash, ashtu si parashikohet në Preventiva dhe në Specifikimet teknike.*

### **16. Mjet (Batipal) për vendosje parrakësh metalik (guardrails)**

*Nisur nga ajo çfarë parashikojnë preventivat dhe specifikimet teknike, ky mjet është i domosdoshëm për realizimin e vendosjes parrakeve mbrojtës anësor metalik (guardrail) së bashku me aksesoret.*

### **17. Fabrikë Asfaltobetonit, e pajisur me QKL, leje mjedisore**

*Një nga zërat kryesorë të Kontrates janë edhe zërat me punimet për ndërtimin e shtresave asfaltike dhe konkretisht me binder, asfaltobeton. Këto asfalte nevojiten për kryerjen e punimeve të riparimit të shtresave asfaltike me anë të riveshjes me binder, asfaltobeton, apo mbushjes së gropave me asfaltobeton. Sipas Specifikimeve Teknike asfaltet që do të përdoren duhet të plotësojnë të gjitha parametrat teknike dhe duhet të prodhohen në një fabrikë asfaltobetonit që të garantojë këto parametra. Nga eksperiencat e Kontratave të mëparshme fabrika duhet të jetë e montuar dhe në gjendje pune pasi nevojat për asfaltobeton mund të lindin në çdo kohë. Gjithashtu fabrikat e asfaltobetonit duhet të jenë të pajisura me leje mjedisore pasi ato shkaktojnë ndotje mjedisore.*

*Kjo është e përcaktuar edhe në VKM n.r 628 datë 15.07.2015 ose Ish – KTZ “Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”.*

### **18. Borepastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)**

*Nevojiten për pjesën e kontrates që ka lidhje me mirëmbajtjen dimërore të akseve rrugore. Këto mjete janë të domosdoshme për kryerjen e mirëmbajtjes dimërore. Këto mjete shërbejnë për pastrimin e rrugës nga reshjet e deboret dhe për hedhjen e kripes gjatë rënies së deboret dhe gjatë periudhave me ngrica.*

*Nisur nga specifikat e objektit kur rreshjet e deboret bien në trajtesisht në të gjithë objektin dhe nisur nga eksperiencat e kaluara është parashikuar që një mjet borepastrues nevojitet për mesatarisht 15 km rrugë mirëmbajtje dimërore.*

*Për të realizuar një shërbim sipas kushteve teknike për largimin e deboret nga karrexhata me një borepastruese mund të mbulohet një korsë e rrugës. Me shpejtesinë 10-20km në orë me të cilën levizin borepastrueset mund të realizohet pastrimi në një gjatësi prej rreth 30km të njëjës korsë ose rreth 15km të rrugëve nacionale që janë me dy korsë.*

*Prandaj për vendosjen e numrit të borepastrueseve për secilin lot jemi nisur nga gjatësia e akseve rrugore (në km) dhe nga fakti i sasisë së reshjeve të deboret.*

## 2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1** Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015      Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015    Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

ISO 45001          Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

**Argumentimi:** Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura nShtatorësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

**Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

**Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

**Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze shërbimi /punimi sipas preventivit të shërbimit / punimeve, gjithashtu jemi bazuar në eksperiencat e projekteve të mirëmbajtjes së Bankes Botërore gjatë viteve 2009-2012, 2017-2022, si dhe në eksperiencën e kontratave të mirëmbajtjes së tre Rajoneve gjatë viteve të fundit.**

\*\*\*\*\*

**- Loti 5: Mirëmbajtje me performancë: Libonik - Lozhan - Molla Grabove (kufi Gramsh), L = 53.1 km me vlerë totale 182,250,868.73 (njëqind e tetëdhjetë e dy milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e tre) Lekë pa TVSH. / Në Euro: 1,845,017.90 (një milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë).**

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 12;

b. Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 5;

c. Formularin e Ofertës Ekonomike, sipas Shtojcës 3; (Faza e dytë)

d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 4; (Faza e dytë)

e. Listën e Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 6.

f. Formularin e Kërkesës për pjesëmarrje, sipas Shtojcës 1.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Sipas Shtojcës Nr. 12

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës (vlera e fondit limit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

*Lloji i procedure është "Sherbim" Mbi kufirin e larte monetar", përcaktimi i vleres se kerkuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "a" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " dyfishin e vleres se perllogaritur te kontrates ose Lotit" Eshte përcaktuar "Jo me e vogel se vlera e parashikuar e kontratës qe prokurohet " me argumentimin per te pasur me shume konkurence " dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, *ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, *Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, si dhe *kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*. Referuar në nenin 29 të *Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej***

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 30 % të vlerës** së fondit të limit të lotit përkatës, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- kontratën dhe vërtetimet të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit
- situacionet dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- situacionet dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- kontratën dhe vërtetime për përmbushjen me sukses të saj, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.4.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar me VKM Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”. Shqyrtimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara sa me siper. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Licensa	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4/C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5/A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-12/A	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-5/A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
6	NS-6/B	Sinjalistika rrugore jondriçuese
7	NS-7/A	Barriera dhe mbrojtja rrugore

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”



Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1-A	Punime gërmimi në tokë	Punime gërmimi në trupin e rruges, në rrugë dytesore, në vepra arti të vogla, në rjetin e kanalizimit të ujrave të shiut, si dhe në punimet për linjat rezerve	0-20Mln	467,648.00
NP-4-C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale	Përfshin gjithë punimet në rrugë.	51-100 Mln	62,344,385.29
NP-5-A	Punime nëntokësore, ura, vepra arti	Punime vepra arti të vogla dhe të mëdha	0-20 Mln	16,413,092.07
NP-12-A	Punime inxhinierike mjedisore	Punime prishje, gërmimi, dhe gjelberimi	0-20 Mln	6,234,438.53
NS-5/A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	Punime sinjalistike ndriçuese	0-20 Mln	408,444.33
NS-6- B	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike	21-50 Mln	29,160,161.09
NS-7- A	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje Guardrail	0-20 Mln	2,692,991.12

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **34 (tridhjetë e katër) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri,

operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Shtator 2024**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas

Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Shtator 2024**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Shtator 2024**.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Duke qenë se objekti është shërbime dhe shërbime në vazhdimësi për një periudhë 48 mujore të marrëveshjes kuadër dhe kontratat do të lidhen sipas nevojave të autoritetit është e vështirë për të mos thënë e pamundur që numri i punëtorëve për këtë objekt të përcaktohet sipas oreve të punës, pasi orët e punës në këto objekte variojnë edhe sipas stinëve dhe në mënyrë të veçantë edhe sipas kushteve të motit (psh sqarohet këtu në stinën e dimrit në këtë aks rrugor orët e punës për pastrimin e borës mund të jenë shumë të zgjatura, apo në stinën e vjeshtës për shkak të reshjeve të shiut mund të shkaktohen shembje të cilat kërkojnë orë të konsiderueshme pune).

Prandaj në lidhje me përcaktimin e numrit të punonjësve është përdorur edhe eksperiencia e mëparshme ndër vite duke kërkuar një 1 punëtor për 3 km (një sugjerim i tillë ka qenë bërë edhe në specifikimet teknike të modelit të vjetër, atyre të përdorura para vitit 2015), duke qenë se edhe nga eksperiencia e të gjitha këtyre viteve ka rezultuar e sukseshme dhe i mjaftueshëm një numer i tillë punëtorësh për të realizuar shërbimin e mirëmbajtjes.

Edhe në seminarin e organizuar nga DPRR në Korrik 2010 në lidhje me kontratat e mirëmbajtjes është konkluduar që për të garantuar shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes duhet minimalisht 1 punëtor për 3 km rrugë. Kjo llogaritje është bërë për secilin lot bazuar në km.

Për të garantuar shërbimet me cilësi dhe për të garantuar sigurinë teknike gjatë kryerjes së shërbimeve në rrugë mjetet kryesore duhet të jenë të pajisur me manovratorë.

Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar (për secilin lot) si borëpastruese, fadroma, dhe (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltshtruesja të cilët kërkohet që drejtuesit të jenë të specializuar janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se këto mjete

nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.

Ndërsa mjete të tjera janë kërkuar, Kamionat, kamioncine, autobetoniere, (per secilin lot) dhe rrjedhimisht kërkohen drejtues automjeti (shoferë).

Pra pervec punëtove të thjeshtë, janë kërkuar edhe manovratore dhe shoferë të cilët duhen për realizimin e shërbimeve të kërkua në kontrate. Kështu që për secilin lot janë kërkuar puntorë bazuar në km e secilit lot, manovratorë sipas mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.9 si dhe shoferë për drejtimin e automjeteve të kërkua po në pikën 2.3.9 për secilin lot. (punëtove + manovratore + shofera = në total nr punonjësish)

Për llogaritjen e numrit të punonjësve për punimet e rehabilitimit jemi bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës.

**2.3.4 Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) inxhinier Ndërtimi / 1 (një) inxhinier Hidroteknik, i cili do të jetë Drejtues teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt.**

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtove të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. *drejtuesin teknik të shërbimeve duhet të jetë në licencën e shoqërisë dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt pasi do jetë ai drejtuesi i të gjitha shërbimeve dhe punimeve për objektin*

**2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:**

**1 (një) inxhinier Topograf,**

**1 (një) inxhinier Mekanik,**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Topograf dhe inxhinieri Mekanik. Këto inxhinierë janë kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë. Në specifikimet teknike janë përcaktuar punime të mirëmbajtjes dhe punime të sinjalistikës në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm ing. Mekanik.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin mbështetës**, si më poshtë:

**1 (një) inxhinier Gjeolog / Gjeoteknik,**

**1 (një) inxhinier Mjedisi (i përfshirë në licencën e shoqërisë),**

**1 (një) inxhinier Elektrik,**

\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit mbështetës të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Gjithashtu argumentojmë se kemi të bëjmë me kontrata komplekse ku përfshihen shërbime mirëmbajtje rutinë me performancë dhe punime në rrugë, si punime rehabilitimi dhe emergjence. Dhe si rrjedhim është i domosdoshëm inxhinieri Gjeolog / Gjeoteknik, ing. Mjedisit si dhe ing. Elektrik. Në punimet e emergjences kemi situata nga më të ndryshmet si rrëshqitje të cilat kërkojnë të pranishëm gjeolog, ku dhe është kërkuar me kategoritë e licencimit sipas specifikimeve teknike. Inxhinieri i Mjedisit është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të gjelbërimit, si dhe punime estetike në rrugë, të cilat e bëjnë të domosdoshëm atë. Në zbatim të vendimeve të KPP-së, Inxhinieri i Mjedisit duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë.*

*Inxhinieri Elektrik është kërkuar bazuar në preventivin e punimeve të rehabilitimit si dhe në punimet rutinë në specifikimet teknike ku janë përcaktuar punime të spostimit të linjave elektrike.*

**2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës manovratorë.** Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese” për të cilët duhet të paraqesë kontrate individuale të punës të vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Duke u nisur nga mjetet që janë kërkuar si borëpastruese, fadroma, dhe (per mjetet e tjera te vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja te cilet kërkohe qe drejtuesit te jene te specializuar), janë kërkuar manovratorë (për mjetet e tjera të vogla si grejderi, rruli, ekskavatori dhe asfaltoshtruesja është kërkuar një 1 manovrator i vetëm duke qenë se këto mjete nuk kërkohet të dalin në punë për një herë në të njëjten kohë) pra kemi përcaktuar një numër të nevojshëm manovratorësh.*

**2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar / kualifikuar si më poshtë:**

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “**Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

\*\*\* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 12. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës*

*Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.*

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Makinerive</b>	<b>Pronësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Frezë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	në pronësi ose me qira	Copë 4
11	Kamionçinë deri në 3.5ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Mjet (Batipal) për vendosje parrakësh metalik (guardrails)	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Fabrikë Asfaltbetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim	Copë 1
18	Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)	në pronësi ose me qira	Copë 4

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 12.** “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, **si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse; Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e asfaltit, të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit mund të paraqesë

edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

### **1. Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton**

*Referuar territorit ku kalojnë akset rrugore shembjet e dherave dhe depozitimi i aluvioneve ne trup te rruges jane te shpeshta. Per kete arsye per te realizuar ne nje kohe shume te shpejte largimin e dherave qe mund te bllokojne rrugen dhe per te kryer nje pastrim sa me te shpejte nevojiten mesatarisht 1 kamion per 20 km.*

*Nisur nga natyra e kontratës (specifikimeve teknike) ku kontraktori është i detyruar që të pastroj kanalet, veprat e artit dhe rrëshqitjet e shpateve etj deri në 500 m<sup>3</sup>, duke pasur parasysh gjatesine e rrugeve per sejcilin lot eshte gjykuar që nevojiten kamjone vetshkarkues për përmbushjen e kontratës. Sasia e mjeteve vetshkarkuese eshte ne varesi te km per sejcilin lot. Gjithashtu nevojiten mjete transporti edhe per transportimin e gjithe materialeve te nevojshme per punime dhe sherbime te ndryshme ne objekt si psh: asfaltobeton, inerte, material per mbushje te trupit te rruges, sinjalistike rrugore, etj.*

### **2. Grejder**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te nivelimit kryesisht gjate punimeve te riveshjes se shtresave asfaltike, nivelimi i bankinave, etj.*

### **3. Rul vibrues**

*Nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme gjate riveshjeve me asfalt, per ndertimin e shteses se stabilizantit, binderit e asfaltobetonit, si dhe gjate te mbushjes te gropave me asfalt mbeshtetur ne specifikimeve teknike.*

### **4. Prerese asfalti**



*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet minimalisht kjo makineri prerese asfalti per te bere prerje te asfaltit te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve mbushje gropash sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **5. Freze asfalti**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **6. Betoniere**

*Për realizimin e punimeve ku përfshihen zërat për betonimin e fragmenteve që kanë nevojë, duhet minimalisht një betoniere për pregatitjen e betoneve.*

#### **7. Autobot Uji**

*Per realizimin e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere frezim te shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **8. Autobitumatriçe**

*Per realizimn e punimeve te asfaltimit apo mbushjes se gropave, nevojitet edhe kjo makineri per te bere vazhduar sipas radhes teknologjike ndertimin e shtresave asfaltike te demtuar na rastet kur lind e nevojshme kryerja e punimeve te reja te riveshjes se shtresave asfaltike sipas parashikimeve ne preventiv dhe specifikimeve teknike.*

#### **9. Asfaltoshtruese**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te riveshjes se segmenteve rrugore me shtresa perkatese asfaltike (binder, asfaltobeton).*

#### **10. Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët.**

*Nisur nga parashikimet e preventivit dhe specifikimeve ky mjet nevojitet gjate procesit te prerjes se bimesise se ulet (barit, etj.) anash bankines.*

#### **11. Kamionçinë deri në 3.5ton**

*Nevojitet per transportin e matrialeve te ndryshme, levizjen e fuqise punetore, veglave te punes, per levizjen e stafit menaxherial, etj. Duke patur paraysh që kontraktori duhet të bëjë edhe kontrollin (monitorimin) e aksit, eshte konsideruar e mjaftueshme nje kamioncine per 30 km.*

#### **12. Miniekskavator**

#### **13. Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)**

#### **14. Ekskavator me goma**

*Te gjitha keto mjete **Minieskavator, Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent), Eskavator me goma,** nevojiten per punime te ndryshme ne rastet e pastrimit te sipërfaqes se rruges nga depozitimi i dherave dhe inerteve si pasoje e reshqitjeve nga skarpatat e siperme te rruges, ne rastet e depozitimit te aluvioneve qe sjellin lumenjte, perrenjte, kanalet e ndryshme, etj.,*

*Pra me konkretisht fadroma sherben per largimin e shembjeve dhe ngarkimin e tyre ne kamionat veteshkarkues, apo per shtyrjen e grumbujve te debores. Ne rastet e bllokimeve eshte e domosdoshme nje mjet pastrimi fadrome me kapacitet minimalisht 0.4-1m<sup>3</sup>*

*Ndersa eskavatori, sherben per pastrimin e kanaleve dhe ne rastet e shembjeve bashke me fadromen koordinojne punen per pastrimin dhe evadimin e dherave me kaminat veteshkarkues. Nga eksperiencia eshte e domosdoshme qe mjeti i germimit ekskavator te jete me kapacitet minimalisht 0.4-1m<sup>3</sup>.*

#### **15. Makineri për vijëzim rrugor**

*Makineria e vijezimit te rruges sherben per te ribere vijezimin e rruges ne varesi te konsumimit te vijezimeve ekzistuese, si dhe per vijezim te ri ne zonat ku behen punime riveshje me asfaltobeton apo mbushje gropash, ashtu si parashikohet ne Preventiva dhe ne Specifikimet teknike.*

#### **16. Mjet (Batipal) për vendosje parrakësh metalik (guardrails)**

*Nisur nga ajo cfare parashikojne preventivat dhe specifikimet teknike, ky mjet eshte i domosdoshem per realizimin e vendosjes parrakeve mbrojtës anesor metalik (guardrail) se bashku me aksesoret.*

#### **17. Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore**

*Nje nga zerat kryesore te Kontrates jane edhe zerat me punimet per ndertimin e shtresave asfalike dhe konkretisht me binder, asfaltobeton. Keto asfalte nevojiten per kryerjen e punimeve te riparimit te shtresave asfaltike me ane te riveshjes me binder, asfaltobeton, apo mbushjes se gropave me asfaltobeton. Sipas Specifikimeve Teknike asfaltet qe do te perdoren duhet te plotesojne te gjitha parametrat teknike dhe duhet te prodhohet ne nje fabrike asfaltobetoni qe te garantoje keto parametra. Nga eksperiencia e Kontratave te meparshme fabrika duhet te jete e montuar dhe ne gjendje pune pasi nevojat per asfaltobeton mund te lindin ne cdo kohe. Gjithashtu fabrikat e asfaltobetonit duhet te jene te pajisura me leje mjedisore pasi ato shkaktojne ndotje mjedisore.*

*Kjo eshte e percaktuar edhe ne VKM n.r 628 date 15.07.2015 ose Ish – KTZ “Per miratimin e Rregullave Teknike te Projektimit dhe ndertimit te rrugeve”.*

#### **18. Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)**

*Nevojiten per pjesen e kontrates qe ka lidhje me mirembajtjen dimerore te akseve rrugore. Keto mjete jane te domosdoshme per kryerjen e mirembajtjes dimerore. Keto mjete sherbejne per*

*pastrimin e rruges nga reshjet e debores dhe për hedhjen e kripes gjate renies se debores dhe gjate periudhave me ngrica.*

*Nisur nga specifikat e objektit kur rreshjet e debores bien njetrajtesisht ne te gjithë objektin dhe nisur nga eksperiencat e kaluara eshte parashikuar qe një mjet borepastrues nevojitet per mesatarisht 15 km rruge mirembajtje dimerore.*

*Per te realizuar nje sherbim sipas kushteve teknike per largimin e debores nga karrexhata me nje borepastruese mund te mbulohet nje korsi e rruges. Me shpejtesine 10-20km ne ore me te cilen levizin borepastrueset mund te realizohet pastrimi ne nje gjatesi prej rreth 30km te njerës korsi ose rreth 15km te rrugëve nacionale qe jane me dy korsi.*

*Prandaj per vendosjen e numrit te borepastrueseve per sejcilin lot jemi nisur nga gjatesia e akseve rrugore (në km) dhe nga fakti i sasise se reshjeve te debores.*

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** *Operatori/ët ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

*ISO 9001:2015      Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë*

*ISO 14001:2015    Sistemet e Menaxhimit Mjedisor*

*ISO 45001          Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*

*Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.*

**Argumentimi:** *Kerkesat e mesiperme jane vendosur bazuar ne Nenin 79, pika 1 te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë*

*të argumentuara dhe të lidhura nShtatorësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Çertifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Specifikimet teknike jane hartuar per çdo ze sherbimi /punimi sipas preventivit te sherbimit / punimeve, gjithashtu jemi bazuar ne eksperiencat e projekteve te mirembajtjes se Bankes Boterore gjate viteve 2009-2012, 2017-2022, si dhe ne eksperiencen e kontratave te mirembajtjes se tre Rajoneve gjate viteve te fundit.***

*Specifikimet teknike, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve jane pjese e pandare e DST.*

**Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.**

\*\*\*\*\*